



VENDIM
I DREJTORIT TE PERGJITHSHEM
TE QENDRES KOMBETARE TE REGJISTRIMIT

Prot: 10043/1

Tirane me: 12.062012

Sot ne Tirane me date: 12/06/2012, une Titullari i Qendres Kombetare te Regjistrimit, Tomi Kola, mora ne shqyrtim: Ankimin Administrativ date: 06.06.2012, protokolluar me tonen Nr. 10043 Prot. date: 07.06.2012, paraqitur nga Z. Albert Xhani, **me objekt**: "Çregjistrimin nga regjistri tregtar i shoqërisë "Klubi i Futbollit Partizani" sha me NUIS L21804007A regjistruar në QKR në datën 28.05.2012."

KONSTATOVA

I. Se shoqëria "PARTIZANI MEDIA & TRADING" Shpk, eshte nje shoqëri me pergjegjesi te kufizuar e regjistruar prane QKR në datën me NUIS(NIPT) - Numri unik i identifikimit te subjektit K82124008C.

II. Ne QKR me date: 21/05/2012, me numer çeshtje CN-782744-05-12, eshte miratuar aplikimi per ndryshimin e emrit te shoqërise nga "PARTIZANI MEDIA & TRADING" Shpk ne "F.K Partizani" Shpk.

III. Ne QKR me date: 04/06/2012, eshte regjistruar shoqëria me emrin "Klubi i Futbollit "PARTIZANI" Sha, me NUIS L21804007A, me objekt: "Organizimi i aktiviteteve sportive ne fushen e futbollit. 2. Krijimi i ekipeve zinxhir per sportin e futbollit, si dhe pjesemarrja ne garat sportive te organizuara nga Federata Shqiptare te Futbollit. 3. Futja ne tregun e lojtareve per te blere lojtare sipas nevojave te ekipit. 4. Aktivitete te tjera ne fushen e futbollit per interes te

Faqe | 1



shoqërisë. 5. Aderimi dhe regjistrimi si klub në Federatën Shqiptare të Futbollit dhe në të gjitha llojet e aktiviteteve të futbollit kombëtare dhe nderkombëtare”.

1. **Ankuesi pretendon se,** Veprimi i QKR për pranimin e regjistrimit të shoqërisë “Klubi i Futbollit “PARTIZANI” Sha, përben një veprim në kundërshtim me dispozitat urdhëruese dhe ndalesat shprehimisht të parashikuara nga ligji Nr. 9723, datë: 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Dhe kjo, pasi emri i kësaj shoqërie është i njëjti dhe shumë i ngjashëm me emrin e 2 shoqërive të tjera tregtare, të regjistruara më parë në regjistrin tregtar, konkretisht: “Partizani” Sha, me NUIS: K02322003T dhe shoqëria “F.K Partizani” SHpk, me NUIS: K82124008C, me përfaqësues ligjor z. Albert Xhani.

Në lidhje me këtë pretendim sqarojmë se:

Në bazë të Ligjit “Për QKR”, Neni 54, një nga detyrimet e nëpunësit të autorizuar gjatë shqyrtimit të aplikimit për regjistrimin fillestar është verifikimi i emrit të subjektit që kërkon të regjistrohet. Këtë detyrim e parashikon shkronja dh) e nenit 54, e cila citon: “nëse emri i zgjedhur mund të regjistrohet...”

Neni 32 i Ligjit nr. 9723, datë: 03.05.2007 “Për QKR”, citon: “Për regjistrimin fillestar të shoqërive tregtare janë të detyrueshme këto të dhëna:

a) emri...

Sipas shkronjës (a) të këtij neni emri i shoqërisë është e dhënë e detyrueshme për regjistrimin fillestar.

Neni 23 i Ligjit “Për QKR”, “Rregullat e emërimit”, përcakton: “1. Ndalohet regjistrimi në regjistrin tregtar i subjekteve me emra të njëjtë ose të ngjashëm, me emra në trajtën e shquar apo shkurtimet përkatëse të shteteve, qyteteve, krahinave gjeografike, organizatave ndërkombëtare, fetare ose institucioneve të pushtetit qendror apo vendor, pa shtesa dalluese ose me emra, që janë në kundërshtim me rendin e moralin publik apo me dispozitat urdhëruese të ligjit.

2. Regjistrimi i emrit kryhet në bazë të parimit të përparësisë së paraqitjes së aplikimit.

Faqe | 2



3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat për emrat dhe emërtimet tregtare.”

Sipas pikës 1 të këtij neni, ndalohet regjistrimi në regjistrin tregtar i subjekteve me emra të njëjtë ose të ngjashëm.

Në bazë të VKM Nr. 537, date: 01.08.2007, “Për Rregullat Për Emrat dhe Emërtimet Tregtare”, pika 2 citon: “Ndalohet regjistrimi në regjistrin tregtar, pranë QKR-së, i personave juridikë, përfshirë degët apo zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja, të cilët aplikojnë për regjistrim fillestar, duke deklaruar një emër, të njëjtë apo të ngjashëm, me emrin e regjistruar apo të rezervuar më parë nga një subjekt tjetër. I njëjti ndalim zbatohet edhe në rastin e ndryshimit të emrit të personit juridik apo të rezervimit të emrit, në përputhje me dispozitat e ligjit për QKR-në.”

Në QKR me numër çështje CN-790322-05-12, është kryer aplikimi për regjistrimin fillestar të shoqërisë me emrin **Klubi i Futbollit "PARTIZANI" Sha**. Nëpunësi i autorizuar i QKR, gjatë shqyrtimit të aplikimit, duhet të verifikonte emrin e këtij subjekt në bazë të Nenit 54 shkronja dh), nenit 23, pika 1 të Ligjit 9723 dhe Vkm nr. 537 date: 01.08.2007 , pika 2.

Nga ana e QKR, nuk rezulton që ky verifikim të jetë bërë, pasi në regjistrin tregtar në momentin e aplikimit dhe shqyrtimit të çështjes me numer CN-790322-05-12, rezultonin të regjistruara disa subjekte me emra të ngjashëm dhe të njëjtë me emrin **Klubi i Futbollit "PARTIZANI" Sha**.

Konkretisht në regjistrin tregtar rezultojnë të regjistruara subjektet:

- a) “FUTBOLL KLUB PARTIZANI” me NUIS L02031004S, regjistruar më datë 31.08.2010.
- b) “F.K Partizani” Sh.p.k me NUIS K82124008C, regjistruar në datën 24.09.2008.
- c) “PARTIZANI” Sh.a. me NUIS K02322003T, regjistruar më datë 22.11.2000.

Për shkak të pengesave ligjore që egzistonin në lidhje me emrin, subjekti **Klubi i Futbollit "PARTIZANI" Sha**, nuk duhej të regjistrohej në regjistër me këtë emër. Ky regjistrim nuk është kryer në përuthje me Ligjin 9723 "Për QKR".

2. Per sa i perket arsyetimit të parashtruar në ankimin administrativë se, shoqëria "PARTIZANI" Sha, është regjistruar si person juridik në datën: 06.11.2000, ka regjistruar pranë Drejtorisë së Patentave dhe Markave, në kushtet e Ligjit nr. 7819, datë: 27.04.1994, "Për Pronesinë Intelektuale", markën: " FUTBOLL KLUB PARTIZANI" (fjalë dhe figurë), fakt i cili provohet me anë të regjistrimit me nr. 11689, për të cilin është lëshuar Certifikata e Regjistrimit nr. 252/7, datë: 17.04.2008. Ky regjistrim i markës në fjalë është bërë për fjalët " Futboll Klub Partizani" dhe për figurën, stemen dhe ngjyrat e mbrojtura sipas peshkrimit grafik të kësaj marke, sqarojmë:

Në bazë të VKM Nr. 537, datë: 01.08.2007, "Për Rregullat Për Emrat dhe Emërtimet Tregtare", pika 28 citon: *"Çdo person i interesuar, në bazë të nenit 638 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë e të dispozitave, që rregullojnë pronësinë industriale, mund të kërkojë, në rrugë gjyqësore, ndalimin e përdorimit apo çregjistrimin e emrit të personit juridik, nëse ai cenon një markë të regjistruar më parë apo emrat, emërtimet tregtare e shenjat dalluese të përdorura ligjërisht më parë nga të tretët (pavarësisht publikimit të tyre në regjistrin tregtar, sipas ligjit për QKR-në)."*

Sipas pikës 28, një markë apo emër të regjistruar më parë sipas dispozitave ligjore në fuqi, çenohet apo përdoret nga personat të tretë të pa autorizuar, çdo person i interesuar mund të drejtohet gjykatës.

Në bazë të Ligjit 9723, QKR, nuk e ka kompetencë të verifikojë paraprakisht nëse një markë apo emër është regjistruar në regjistrin e markave dhe patentave.



VENDOSA

1. Pranimin pjesërisht të ankimit administrativ me Nr. 10043 Prot. date: 07.06.2012, paraqitur nga Z. Albert Xhani.
2. Çregjistrimin nga regjistri tregtar te emrit Klubi i Futbollit "PARTIZANI".
3. Detyrimin e subjektit te regjistroje nje emer te ri nepermjet aplikimit.
4. Ngarkohet Drejtoria e Regjistrimit për zbatimin e këtij vendimi administrativ.
5. Kundër këtij vendimi, mund te kryhet ankim në Gjykatën e Rrethi Gjyqësor Tirane, sipas nenit 328 të Kodit te Procedurës Civile.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHEM

